



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.47, datë 06.07.2016

Për

**“KRIJIMIN E QENDRËS RINORE TEN SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronjat “b” dhe “c” dhe pika 1/1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 25, nenit 54, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 121, pika 1, 124, pika 1, nenit 125 dhe nenit 126, pika 1 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 3.4.1993 për “Kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.09.2006 për “Kalimin e Kinemave “Dajti”, “Agimi” dhe “Lapraka” në varësi të Qendrës Kulturore “Tirana”, një ndryshim në strukturën dhe buxhetin e saj, si dhe transferimin e aktiveve të qëndrueshme, qarkulluese dhe detyrimeve debitore e kreditore të administratës së kinemave, sipas bilancit të datës 31.03.2006, në Qendrën Kulturore “Tirana”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.10.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Kulturore “Tirana”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë sa më poshtë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e “Qendrës Rinore TEN” si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Detyra institucionale e funksionale të këtij institucioni do të jetë mbështetja, promovimi i pjesëmarrjes dhe agazhimit aktiv rinor, si dhe kultivimi i talenteve të reja, me fokus të veçantë në krijimtarinë artistike dhe artin bashkëkohor.
2. Të miratojë stemën zyrtare të Qendrës Rinore sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Qendrës Rinore në 7 punonjës.

4. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Qendrës Rinore sipas Lidhjes së Pagave nr.17, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2016.
6. Të miratojë pakësimin me 5 punonjës të Qendrës Kulturore Tirana duke filluar nga data 1 Gusht 2016.
7. Të shfuqizojë pikën 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 09.10.2012 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Kulturore “Tirana”.
8. Të miratojë transferimin kapital nga administrata e Qendrës Kulturore “Tirana” të objektit ish kinema “Dajti” të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, qarkulluese dhe disponibiliteteve në shumën që i përkasin administrimit të këtij objekti sipas vlerave të bilancit kontabël në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Të miratojë kalimin e detyrimeve që i përkasin objektit ish kinema “Dajti” në Bashkinë e Tiranës sipas vlerave të bilancit kontabël në ditën e kryerjes së transferimit.
10. Në mbështetje të pikës 1 dhe 9 të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë që të kryejë kalimin kapital të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, qarkulluese dhe disponibiliteteve tek Qendra Rinore TEN.
11. Në mbështetje të pikës 4 të këtij vendimi rekomandohet hartimi dhe miratimi i menjëhershëm i strukturës organizative dhe i rregullores së funksionimit të brendshëm të Qendrës Rinore TEN.
12. Ngarkohet Qendra Kulturore Tirana, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike Aseteve dhe Licencave për zbatimin e këtij vendimi.
13. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI